

ABSTRAKT

Ky hulumtim është realizuar me temën “Adoptimi si formë e mbrojtjes së fëmijës, problemet praktike”.

Familja si bashkësi vitale dhe bërthama themelore e shoqërisë përbëhet nga prindërit, fëmijët dhe persona të tjerë në gjini. Mirëpo ekzistojnë raste dhe kushte të ndryshme kur fëmijët mbesin pa kujdes prindëror dhe atyre iu nevojitet mbrojtje e posaçme. Këtu përfshihen fëmijët e prindërit e të cilët nuk janë gjallë, janë të panjohur ose të zhdukur, apo prindërit e fëmijëve të cilët për çfarëdo arsye nuk i kryejnë detyrat e tyre prindërore në mënyrë të përkohshme ose të përhershme.

Edhe pse ekzistojnë forma të ndryshme të mbrojtjes së fëmijët pa përkujdesje prindërore siç janë kujdestaria, strehimi familjar dhe strehimi rezidencial, adoptimi paraqet njërën prej formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare të këtyre fëmijëve, sidomos kur fëmija nuk mund të kthehet në familjen e tij/saj biologjike

Adoptimi, i cili në Kosovë rregullohet me Ligjin për Familjen, ka një rëndësi të veçantë jo vetëm për të ofruar një ambient familjar për fëmijët pa përkujdesje familjare, por edhe për funksionimin e mirëfilltë të shoqërisë. Andaj, duke i pasur parasysh këto rrethana, kjo temë e diplomës ka për qëllim të prezantojë dhe interpretojë kornizën ligjore për realizimin e procesit të adoptimit dhe rezultatet e tij, si dhe t’i paraqesë praktikën gjyqësore dhe problematikat që paraqiten gjatë kësaj praktike në Kosovë.

Ky punim është realizuar duke përdorur metoda të ndryshme juridike, të cilat përfshijnë metodën analitike, historike, të krahasimit, atë empirike dhe metodën e studimit të rasteve individuale.

Tema e diplomës përmban 5 kapituj. Në kapitullin e parë bëhet përkufizimi dhe paraqitja e nocionit të adoptimit, e më pas paraqitet vështrimi historik, se si ka filluar të realizohet procesi i adoptimit në periudhat e hershme, sidomos në të drejtën romake, e më pas se si është zhvilluar ky proces historikisht në Kosovë.

Në kapitullin e dytë është paraqitur korniza ligjore e adoptimit në Kosovë, ku paraqitet Ligji për Familjen, duke i përshkruar procedurat si ndërmjetësimi i adoptimit, parimet e adoptimit, pëlqimi për adoptim, i adoptuari, adoptuesi, procedura e adoptimit, efekti ligjor i adoptimit, mbiemri i fëmijës, ndalimi i zbulimit dhe hetimeve, si dhe shuarja e adoptimit. Përveç kësaj janë paraqitur edhe dispozitat ligjore nga Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2014 për Rregullimin e Procedurave të Adoptimit për Fëmijët pa Përkujdesje Prindërore, si dhe nga konventat ndërkombëtare si Konventa e Hagës.

Në kapitullin e tretë trajtohet aspekti komperativ me vendet e rajonit. Pra bëhet përshkrimi i kornizës ligjore për procesin e adoptimit në shtetet e rajonit si në Shqipëri, Maqedoni dhe Turqi, duke shtjelluar zhvillimin e procedurës së adoptimit në këto shtete, që nga paraqitja e kërkesës për adoptim e deri tek përfundimi i kësaj procedure, respektivisht themelimi i adoptimit. Gjatë paraqitjes së legjislacionit përkatës, po ashtu është bërë krahasimi i dispozitave ligjore të këtyre shteteve me kornizën ligjore të Kosovës, ku përveç ngjajshmërive janë paraqitur edhe dallimet, por edhe rrethanat të cilat në legjislacionin e Kosovës nuk janë të paraparë.

Në kapitullin e katërt paraqiten rastet dhe praktikat e ndryshme të procesit të adoptimit nga Gjykata Themelore në Prizren, si dhe janë paraqitur praktikat e Qendrave për Punë Sociale, përkatësisht të Organit të Kujdestarisë. Këtu është sqaruar qartë roli i Organit të Kujdestarisë dhe Panelit për Adoptim, të cilët i realizojnë procedurat e nevojshme sociale për adoptim të fëmijës, si dhe të gjykatave, i cili luan rolin kryesor në themelimin e adoptimit. Në këtë kapitull po ashtu janë paraqitur disa shembuj me procesverbale të përpiluara nga Gjykata Themelore në Prizren

Në kapitullin e pestë janë paraqitur problemet në praktikë dhe vlerësimet e ndryshme lidhur me legjislacionin përkatës për procedurën e adoptimit në Kosovë.

Në përfundim të këtij hulumtimi janë ofruar konkluzione të cilat mund të ndihmojnë në adresimin e sfidave dhe përmirësimin e politikave për realizimin e një procesi të mirëfilltë të adoptimit, gjithmonë duke ndjekur interesin më të lartë të fëmijës.